



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo

## **RREGULLORE**

## **PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM**

Prishtinë, 9 korrik 2019

Në mbështetje të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 14, neneve 15, 23, dhe 24 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, dt. 4 qershor 2008) dhe nenit 41 dhe 42 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 7, dt 01 mars 2019),

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil (më tutje “AAC”) nxjerr Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me organizimin e brendshëm të AAC-së, ndarjen nëpër njësi të brendshme administrative (më tutje “struktura”), udhëheqjen, fushëveprimin dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
2. Sistemimin e vendeve të punës në funksione përkatëse, përshkrimin e detyrave të punës, numrin e ekzekutuesve, klasën e secilës pozitë të kategorisë profesionale dhe kualifikimet e nevojshme për secilin vend pune.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për nëpunësit e AAC-së.
2. AAC sipas nenit 130 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil është agjenci që rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës. AAC është themeluar në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës dhe nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, si agjenci e pavarur rregullatore në fushën e aviacionit civil, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilës janë të përcaktuara në Ligjin për Aviacionin Civil (më tutje LAC).

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, definicionet dhe shprehjet në vijim, kurdo që përdoren, kanë kuptimin e përcaktuar si më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto definicione apo shprehje përdoren, ka ndonjë kuptim tjetër.
  - 1.1 Bord Mbikëqyrës – organ kolektiv mbikëqyrës i AAC-së, i themeluar sipas procedurës së paraparë në Nenin 16 të LAC dhe me kompetenca të parapara në Nenet 17-19 të LAC;
  - 1.2 Drejtor i Përgjithshëm – nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së;
  - 1.3 Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm – nënkupton Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së;

#### **Neni 4**

### **Kompetencat dhe përgjegjësitë**

1. AAC si organ rregullator i aviacionit civil në Republikën e Kosovës është përgjegjës për:
  - 1.1 Rregullimin e sigurisë së aviacionit civil, dhe
  - 1.2 Rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror.
2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

#### **Neni 5**

### **Bordi Mbikëqyrës**

1. Bordi Mbikëqyrës është organ i cili mbikëqyr dhe shqyrton aktivitetet dhe vendimet e AAC-së lidhur me çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore dhe të licencimit, dhe të gjitha aspektet e menaxhimit financiar, të ardhurave dhe shpenzimeve të AAC-së.
2. Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me departamentet përkatëse përpilon raport tre mujor të cilin ia dorëzon anëtarëve të Bordit së paku një javë para mbledhjes së Bordit, por jo më vonë se tri javë pas përfundimit të tremujorit të periudhës raportuese.
3. Përveç raportit të paraparë me nenin 7 të kësaj Rregulloreje, Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me strukturat udhëheqëse përpilon një raport gjithëpërfshirës për punën dhe veprimtarinë e AAC-së për periudhën e kaluar 12 mujore deri me 31 mars të çdo viti kalendarik, të cilin ia dorëzon Bordit Mbikëqyrës, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Drejtori i Përgjithshëm raporton dhe përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me politikat e aviacionit civil dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme nga AAC.

## **KREU II ORGANIZIMI I BRENDSSHËM**

### **Neni 6 Struktura organizative**

1. Në përmbushje të detyrimeve ligjore të cilat dalin nga paragrafi 1, neni 15 i Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, dhe me qëllim të ushtrimit sa më efikas të këtyre kompetencave, Drejtori i Përgjithshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për organizimin e administratës shtetërore themelon strukturën organizative të AAC-së.
2. Struktura organizative e AAC-së përbëhet nga:
  - 2.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
  - 2.2 Departamentet;
  - 2.3 Divizionet;
  - 2.4 Njësitë;
3. Numri i pozitave në AAC është katërdhjetë e nëntë (49).

### **Neni 7 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm përbëhet nga:
  - 1.1 Drejtor i Përgjithshëm;
  - 1.2 Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm;
  - 1.3 Zyrtar ekzekutiv;
  - 1.4 Zyrtar i marrëdhënieve me publikun;
  - 1.5 Zyrtar Certifikues;
  - 1.6 Njësia e Cilësisë dhe Menaxhimit të Sigurisë;
  - 1.7 Asistent i transportit;
2. Numri i pozitave në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm është nëntë (9).
3. Drejtori i Përgjithshëm është organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ të AAC-së. Ai ushtron detyrat dhe funksionet të përcaktuara në Ligjin për Aviacionin Civil dhe në përputhje me legjislacionin tjetër në fuqi.
4. Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së është organ i lartë drejtues në hierarkinë e AAC-së. Procedura për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm është e njëjtë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm.
5. Zyrtari Ekzekutiv – bënë koordinimin dhe ofron mbështetje Drejtorit të Përgjithshëm në kryerjen e të gjitha funksioneve ekzekutive dhe administrative. Për detyrat dhe përgjegjësitë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm. Përshkrimi i detyrave të punës për këtë pozitë është në Shtojcën një (1) të rregullores.
6. Zyrtari për marrëdhënie me publikun – ka për qëllim informimin, komunikim me publikun dhe ofron përkrahje profesionale Drejtorit të Përgjithshëm. Përshkrimi i detyrave të punës për këtë pozitë është në Shtojcën një (1) të rregullores.

7. Zyrtari certifikues - Ka për qëllim sigurimin se shpenzimi i parasë publike për çdo aktivitet të institucionit të bëhet në harmoni me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe procedurave tjera nga kjo lëmi. Përshkrimi i detyrave të punës për këtë pozitë është në Shtojcën një (1) të rregullores.
8. Njësia e Cilësisë dhe Menaxhimit të Sigurisë – në kuadër të përgjegjësisë dhe detyrave ka për qëllim:
- Zbatimin e legjislacionit e aplikueshëm në fushën e sistemit të menaxhimit të sigurisë duke përfshirë edhe propozimin për nxjerrje të legjislacionit dhe dokumentacionit përcjellës që buron nga “Kërkesat për Sistem të Menaxhimit për Autoritete” nga Rregulloret e BE-së dhe Shtojca 19 e Konventës për Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (Konventa e Çikagos) për menaxhimin e sigurisë në aviacionin civil;
  - Mban kontakte me palët e jashtme në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë;
  - Organizon dhe promovon aktivitete me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e nivelit të sigurisë;
  - Kontrollon cilësinë e shërbimeve të ofruara nga AAC dhe cilësinë e dokumenteve të hartuara nga AAC dhe nga palët tjera nën mbikëqyrjen e AAC-së;
  - Harton dokumentacionin e nevojshëm dhe koordinon aktivitetet brenda AAC-së për funksionimin e sistemit për menaxhimin e cilësisë;
  - Trajton ndodhitë e raportuara në aviacion, kryen analiza të ndodhive dhe vendos për veprimet e mëtejme në procesin e hetimit të ndodhive;
  - Planifikon dhe realizon auditime të rregullta dhe ad hoc për vlerësimin e rregullsisë së ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë nga aspekti i sigurisë dhe menaxhimit të sistemit të cilësisë dhe sigurisë;

Udhëheqësi i Njësies së Cilësisë dhe Menaxhimit të Sigurisë për detyrat dhe përgjegjësitë raporton tek Drejtori i Përgjithshëm.

Numri i pozitave në Njësinë e Cilësisë dhe Menaxhimit të Sigurisë është tre (3): Udhëheqësi i Njësies, një (1) auditor i sigurisë dhe cilësisë, dhe një (1) analist i të dhënave të sigurisë. Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

9. Asistent i transportit – është përgjegjës për përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarëvajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit. Mbanë të dhënat për sigurimin, mirëmbajtjen, realizimin e të gjitha kërkesave të institucionit lidhur me transportin. Po ashtu kohë pas kohe kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

## **Neni 8** **Departamentet, Divizionet dhe Njësitë**

1. Departamenti i Operimeve dhe Vlefshmërisë Ajrore:

- 1.1 Divizioni i Operimeve Ajrore, dhe
- 1.2 Divizioni i Vlefshmërisë Ajrore.

2. Departamenti i Licencimit dhe Certifikimit:

- 2.1 Divizioni i Licencimit;
- 2.2 Divizioni i Certifikimit, dhe
- 2.3 Vlerësuesi për Mjekësi të Aviacionit

3. Departamenti i mbikëqyrjes së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Aerodromeve dhe Rregullimit Ekonomik:

- 3.1 Divizioni i Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- 3.2 Divizioni i Aerodromeve, dhe
- 3.3 Divizioni i Rregullimit Ekonomik të Aviacionit;

- 4. Divizioni për Standardizim, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Intergrime Evropiane;
- 5. Divizioni i Shërbimeve të Menaxhimit të Përgjithshëm;
- 6. Njësia e Burimeve Njerëzore;
- 7. Njësia e Shërbimit të Menaxhimit Financiar;
- 8. Njësia e Prokurimit Publik.

9. Drejtori i Përgjithshëm mund të themelojë edhe struktura tjera permanente apo të përkohshme, apo të formojë trupa *ad hoc* lidhur me ndonjë çështje brenda fushëveprimit dhe kompetencave të AAC-së sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 9**

### **Departamenti i Operimeve dhe Vlefshmërisë Ajrore**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Operimeve dhe Vlefshmërisë Ajrore janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për transportuesit ajror vendor si dhe operatoreve ajror të cilët operojnë për në dhe nga Republika e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe inspektimet e mjeteve ajrore dhe ekuipazhit;
- 1.2 Planifikon dhe zbaton në tërësi planet vjetore të auditimeve/inspektimeve, mbikëqyrë dhe monitoron performancën e organizatave trajnuese si dhe fushave për të cilat është përgjegjës, në përputhje me metodat, praktikat dhe udhëzimet e zbatueshme për të siguruar një nivel të pranueshëm të kontrollit të sigurisë dhe mbikëqyrjes;
- 1.3 Përpilon rekomandimin për lëshimin, vazhdimin e validitetit dhe ndryshimin e Certifikatës së Operatorit Ajror (AOC) dhe aprovimeve speciale (CAT II, CAT III, LVTO, MNPS, ETOPS, RNAV, RNP, Mallrat e Rrezikshme, Trajnimin fillestar për siguri dhe testimin e ekuipazhit të kabinës); Certifikatës së Organizatave të cilat menaxhojnë vlefshmërinë ajrore të vazhdueshme të mjeteve ajrore CAMO (Part-M Subpart G) në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara; Certifikatës së Organizatave për mirëmbajtjen e mjeteve ajrore dhe komponentëve të tyre (Part-145, Part-M Subpart F) në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara;
- 1.4 Aprovimi i programeve për mirëmbajtje të mjeteve ajrore si dhe Aprovimin e Listës Minimale të Pajisjeve (MEL) të mjeteve ajrore brenda fushëveprimit të Departamentit;
- 1.5 Monitorimi dhe mbikëqyrja e standardeve të sigurisë të cilat kërkohen nga operatorët e aviacionit të përgjithshëm si dhe operatorëve të tjerë relevant të punëve nga ajri;

- 1.6 Përgatitja dhe shpërndarja tek industria e aviacionit e materialit këshillues për praktikatat e operimeve të fluturimit dhe procedurave kur këshillat e tilla nuk garantojnë ndonjë detyrim, por që mund të japin kontribut të rëndësishëm për sigurinë e fluturimeve;
  - 1.7 Përgatitjen e dokumenteve udhëzuese mbi çështjet që i përkasin sigurisë së operimeve ajrore;
2. Drejtori i Departamentit të Operimeve dhe Vlefshmërisë Ajrore për detyrat dhe përgjegjësitë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.
  3. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:
    - 1.1 Divizioni i Operimeve Ajrore, dhe
    - 1.2 Divizioni i Vlefshmërisë Ajrore.

Numri i pozitave në Departamentin e Operimeve dhe Vlefshmërisë Ajrore është shtatë (7). Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

### **Neni 10** **Divizioni i Operimeve Ajrore**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Operimeve Ajrore janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për operime ajrore me aeroplan dhe helikopter;
  - 1.2 Bashkëpunimi me institucionet tjera dhe departamentet përkatëse të AAC-së, në procedurat për dhënien e licencës së operimit të transportuesit komercial ajror;
  - 1.3 Implementimi i mbikëqyrjes së vazhdueshme të kushteve të përcaktuara dhe mbikëqyrjen e sigurisë së operimeve ajrore përmes auditimeve dhe inspektimeve të rregullta dhe ad hoc;
  - 1.4 Realizimi i inspektimeve për vlerësimin e sigurisë së aeroplanëve në platformë (SAFA/SANA);
  - 1.5 Verifikimi dhe miratimi i operimeve të aviacionit të përgjithshëm, parashutistëve, paraglajdistëve, veloristëve dhe operatorëve me SAP;
  - 1.6 Verifikimi për përmbushjen e kushteve për vazhdimin apo ndryshimin e certifikatës së operatorit ajror (AOC), për operime jo-komerciale me aeroplan me motor kompleks apo helikopter, dhe operatorëve për fluturime nga pika A në pikën A, për kryerjen e operimeve të tjera komerciale, duke përfshirë punët nga ajri (Aerial Works);

Numri i pozitave në Divizionin e Operimeve Ajrore është tre (3): Udhëheqësi i Divizionit dhe dy (2) inspektor të operimeve ajrore.

### **Neni 11** **Divizioni i Vlefshmërisë Ajrore**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Vlefshmërisë Ajrore janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për transportuesit ajror vendor dhe vlefshmëri ajrore si dhe verifikimi për vazhdimin apo ndryshimin e certifikatës së organizatave për vlefshmëri ajrore të vazhdueshme të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike së bashku me miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra;
- 1.2 Verifikimi për vazhdimin apo ndryshimin e certifikatës së organizatave për projektimin, prodhimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore dhe komponentëve të aeroplanëve dhe helikopterëve në pajtueshmëri me kushtet e përshkruara;
- 1.3 Verifikimi i organizatave të trajnimit të mirëmbajtjes dhe personelit certifikues në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara;
- 1.4 Verifikimi i organizatave dizajnuese dhe prodhuese (Part-21); Verifikimi i programeve për mirëmbajtje të mjeteve ajrore; Verifikimi i Listës Minimale të Pajisjeve (MEL) brenda fushëveprimit të Divizionit;
- 1.5 Shqyrtimi i kërkesave në bashkëpunim me departamentin përkatës për licenca për miratime të transportuesve ajror dhe certifikimet e transportuesve ajror dhe aprovimet speciale ajrore (RVSM, CAT II, CAT III, MNPS, ETOPS, RNAV, etj.) brenda fushëveprimit të punës;
- 1.6 Implementimi i mbikëqyrjes së vazhdueshme të kushteve të përcaktuara dhe mbikëqyrja e sigurisë së mbajtësve të certifikatave përmes auditimeve dhe inspektimeve;
- 1.7 Realizimi i inspektimeve për vlefshmëri ajrore të mjeteve ajrore (SAFA/SANA);
- 1.8 Vlerësimi i përmbushjes së kushteve për bartjen e Mallrave të Rrezikshme.

Numri i pozitave në Divizionin e Vlefshmërisë Ajrore është tre (3). Udhëheqësi i Divizionit dhe dy (2) inspektor të vlefshmërisë ajrore.

## **Neni 12**

### **Departamenti i Licencimit dhe Certifikimit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Licencimit dhe Certifikimit janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm mbi kërkesat për licencim/certifikim të personelit të organizatave trajnuese, qendrave për mjekësi të aviacionit, ekipazhit, mekanikëve, kontrollorëve të trafikut ajror, aerodromeve, OSHNA-ve si dhe licencave dhe certifikatave tjera që lëshohen nga AAC;
  - 1.2 Përgjegjës për procesin e auditimit certifikues dhe licencues si dhe për lëshimin fillestar dhe të vazhdimin të të gjitha licencave dhe certifikatave, në bashkëpunim me departamentet përkatëse;
  - 1.3 Regjistrimi i mjeteve ajrore në regjistrin kombëtar të mjeteve ajrore civile duke përfshirë këtu edhe regjistrimin dhe menaxhimin e bazës së regjistrit të operatoreve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SMP).
  - 1.4 Organizimi, monitorimi dhe mbikëqyrja e testimit teorik dhe praktik për licencim në bashkëpunim me departamentet tjera;
  - 1.5 Sipas kërkesës së departamentit për mbikëqyrje merr pjesë në inspektime të mjeteve ajrore në platformë (SAFA/SANA);
  - 1.6 Përgatitja dhe shpërndarja tek industria e aviacionit e materialit këshillues për praktikën e licencimit të ekipazhit dhe procedurave që mund të japin kontribut të rëndësishëm për sigurinë, dhe
  - 1.7 Vepron si ndërlidhje e AAC-së me kompanitë ajrore, aeroportet dhe operatorët tjerë për çështje që ndërlidhen me sigurinë e aviacionit;



- 1.8 Harton planin e trajnimeve fillestare ose të vazhdueshme dhe është përgjegjës për vendosjen e kritereve për kredenciale të inspektorëve;
2. Drejtori i Departamentit të Licencimit dhe Certifikimit për detyrat dhe përgjegjësitë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:
  - 3.1 Divizioni i Licencimit;
  - 3.2 Divizioni i Certifikimit, dhe
  - 3.3 Mjekësia e Aviacionit.

Numri i pozitave në Departamentin e Licencimit dhe Certifikimit është tetë (8). Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

### **Neni 13** **Divizioni i Licencimit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Licencimit janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm rreth kushteve të licencimit të ekuipazhit, mekanikëve, kontrollorëve të trafikut ajror si dhe licencave tjera që lëshohen nga AAC si dhe monitoron dhe verifikon përmbushjen e standardeve të aplikueshme kombëtare, ndërkombëtare, si dhe praktikave të rekomanduara;
  - 1.2 Përpilon programin e mbikëqyrjes dhe është përgjegjës për zbatimin e planit vjetor të mbikëqyrjes të divizionit përkatës;
  - 1.3 Kryen auditimet dhe inspektimet e herëpashershme ose të posaçme të sistemit për menaxhimin e sigurisë së organizatave të certifikuara apo aprovuara;
  - 1.4 Në rastet e vlerësimit të aplikacioneve, bënë koordinimin me palët e interesit dhe, varësisht nga vlerësimi teknik, bënë përgatitjen e rekomandimit për vendimin përkatës;
  - 1.5 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve udhëzuese për industrinë që ndërlidhet me praktikën dhe procedurat, e licencimit të ekuipazhit dhe procedurave që mund të japin kontribut të rëndësishëm për sigurinë;
  - 1.6 Identifikimi dhe zgjedhja e problemeve rregullatorë që lidhen me licencat e ekuipazhit, mekanikëve, kontrollorëve ajror, certifikatave mjekësore etj.
  - 1.7 Krijimi i politikave të përgjithshme dhe teknike dhe procedurat mbi të cilat kërkesat e ardhshme të licencimit ku mund të bazohen;
  - 1.8 Hetimin e shkeljeve të mundshme të ligjit të aviacionit civil apo rregullave në lidhje me licencimin dhe inicimin ligjor apo veprim tjetër korrigjues, sipas nevojës;
  - 1.9 Ekzaminimin e rregullave të tanishme dhe të standardeve ndërkombëtare mbi licencat, dhe përcaktimin e nevojës për adaptimin e tipareve kritike të këtyre standardeve të huaja për zbatim kombëtar;

Numri i pozitave në Divizionin e Licencimit është tre (3): Udhëheqës i Divizionit dhe dy (2) inspektor licencues.

### **Neni 14**

## **Divizioni i Certifikimit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Certifikimit janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për certifikime si dhe planifikimin, organizimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të certifikimit për të gjitha certifikatat e lëshuara nga AAC;
- 1.2 Udhëheq proceset e certifikimit fillestar dhe ripërtëritjes si dhe aprovimit dhe regjistrimit të operatorëve dhe organizatave të aviacionit dhe përgatite rekomandimin përkatës;
- 1.3 Mbikëqyrë implementimin e rregulloreve, urdhëresave, udhërrëfyesve dhe procedurave të aplikueshme për mbajtësit e certifikatave;
- 1.4 Monitorimi dhe verifikimi i përmbushjes së standardeve të aplikueshme si dhe praktikave të rekomanduara nga mbajtësit e certifikatave;
- 1.5 Përpilimi i programit të mbikëqyrjes dhe është përgjegjës për zbatimin e planit vjetor të mbikëqyrjes;
- 1.6 Kryen auditimet dhe inspektimet e herëpashershme ose të posaçme të sistemit për menaxhimin e sigurisë së organizatave të certifikuara apo aprovuara, dhe
- 1.7 Koordinon me palët e interesit, dhe varësisht nga vlerësimi teknik, bënë përgatitjen e rekomandimit për lëshimin e vendimit përkatës.

Numri i pozitave në Divizionin e Certifikimit është tre (3): Udhëheqës i Divizionit dhe dy (2) Inspektor Certifikues.

## **Neni 15**

### **Vlerësuesi për Mjekësi të Aviacionit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Vlerësuesit për Mjekësi të Aviacionit janë:

- 1.1 Certifikimin mjekësor për pilotët profesional dhe inxhinierët e fluturimit në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 1 sipas PART-FCL dhe Aneksit 1 të Konventës së Çikagos;
- 1.2 Certifikimin mjekësor për pilotët privatë, pilotët e aeroplanëve pa motor, pilotët e balonëve, pilotët e aeroplanëve ultra të lehtë, parashutistëve dhe në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 2 sipas PART-FCL dhe Aneksit 1 të Konventës së Çikagos;
- 1.3 Certifikimin mjekësor për kontrollorët e trafikut ajror në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 3 të bazuara sipas standardeve të EUROCONTROL-it, dhe anëtarëve të ekuipazhit të kabinës në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 3 sipas PART-FCL;
- 1.4 Kontrollimin e certifikimit mjekësor dhe pjesëmarrjen në certifikimin mjekësor të rasteve problematike dhe rastet e ankesave;
- 1.5 Mbikëqyrë punën dhe funksionimin e Qendrave të Mjekësisë së Aviacionit (AeMC);
- 1.6 Vlerëson ekzaminuesit të autorizuar mjekësorë (AME);
- 1.7 Përcaktimin dhe monitorimin e procesit të trajnimeve në mjekësi të aviacionit;
- 1.8 Përcaktimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve mjekësore në bord të aeroplanit dhe të shërbimeve mjekësore të aeroportit në lidhje me shëndetin e pasagjerëve, dhe
- 1.9 Bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me standardet kombëtare mjekësore dhe sanitare.

Në kuadër të saj është vetëm një (1) pozitë, Vlerësues i Autorizuar Mjekësor. Përshkrimi i detyrave të punës për këtë pozitë gjendet në Shtojcën nr. (1) të rregullores.

## Neni 16

### **Departamenti për mbikëqyrje të shërbimeve të navigacionit ajror, aerodromeve dhe rregullim ekonomik**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Aerodromeve dhe Rregullimit Ekonomik janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për operatorët e aerodromeve dhe ofruesit e shërbimeve në tokë;
  - 1.2 Monitorimi dhe verifikimi i përmbushjes së standardeve dhe praktikave të rekomanduara të operimeve brenda fushëveprimtarisë së departamentit duke realizuar auditime të rregullta dhe ad hoc të sigurisë dhe atyre ekonomike-financiare dhe hartimi i raporteve me rekomandime përkatëse;
  - 1.3 Shqyrtimi i aplikacioneve dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse departamentit për licencim dhe certifikim për aprovimin e aerodromeve, OSHNA, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe organizatave trajnuese të këtyre operatorëve dhe aprovimi i vlerësimeve të aplikacioneve për praninë të ndryshimeve dhe praninë e ndryshimeve në sistemet e SHNA-së, duke përfshirë edhe ndër-veprueshmërinë (interoperability);
  - 1.4 Koordinimi me agjencitë tjera dhe ofruesit e shërbimeve të informimit aeronautikë, të shërbimeve të trafikut ajror, autoritetet e përcaktuara për meteorologji, siguri etj.;
  - 1.5 Planifikimi dhe realizimi i mbikëqyrjeve të Ofruesve të Shërbimeve dhe Ofruesve të Trajnimeve dhe adreson shqetësimet për siguri dhe informon palët përkatëse;
  - 1.6 Përpilimi dhe rishikimi i raporteve dhe rezultateve të mbikëqyrjes për menaxhimin e sigurisë në aerodrome, OSHNA duke përfshirë edhe verifikimin e informatave dhe publikimin e tyre në AIP;
  - 1.7 Kontribon në vetëdijësimin dhe edukimin e përgjithshëm rreth sigurisë në aviacion dhe asiston personelin e autorizuar në hetimin e aksidenteve ajrore;
  - 1.8 Shqyrtimi i tarifave në aeroporte dhe në OSHNA për pajtueshmëri me parimet e Konventës së Cikagos si dhe me rregulloret e AAC-së mbi tarifën në aeroporte dhe OSHNA;
  - 1.9 Shqyrtimi i skemave nxitëse të propozuara nga aeroporti ose OSHNA në pajtueshmëri me rregulloret në fuqi dhe ofron rekomandimet përkatëse;
  - 1.10 Mbledhja dhe analiza e të dhënave statistikore në lidhje me bartjen e udhëtarëve, mallrave dhe postës përmes ajrit.
2. Drejtori i Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Aerodromeve dhe Rregullimit Ekonomik për detyrat dhe përgjegjësitë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:
  - 3.1 Divizioni i Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
  - 3.2 Divizioni i Aerodromeve, dhe
  - 3.3 Divizioni i Rregullimit Ekonomik.

4. Numri i pozitive në Departamentin për mbikëqyrje të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Aerodromeve dhe Rregullimit Ekonomik është dymbëdhjetë (12). Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën nr. (1) të rregullores.

#### **Neni 17**

### **Divizioni i Shërbimeve të Navigacionit Ajror**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për operatorët e certifikuar të OSHNA, planifikimi dhe realizimi i mbikëqyrjeve të rregullta dhe ad hoc të Ofruesve të Shërbimeve dhe Ofruesve të Trajnimeve, dhe rishikimi i raporteve dhe rezultateve të mbikëqyrjes për zbatimin e legjislacionit përkatës, rregullave dhe standardeve për siguri;
  - 1.2 Shqyrtimi i aplikacioneve për licencim të KTA dhe ofrimi i rekomandimeve departamentit për licencim për aprovim të OSHNA, aerodrome dhe ofruesit e shërbimeve në tokë dhe organizatave trajnuese;
  - 1.3 Trajtimi i kërkesave për praninë të ndryshimeve në sistemet e SHNA-së, aerodrome, duke përfshirë edhe ndër-veprueshmërinë (interoperability);
  - 1.4 Propozimi për hartim të rregulloreve dhe udhëzuesve shoqëruar si dhe ofrimi i përkrahjes në proceset shoqëruar të konsultimit publik;
  - 1.5 Hetimi i ndodhive lidhur me shkeljet e rregullave të sigurisë dhe rekomandimi i veprimeve korrigjuese për rritjen e sigurisë së shërbimeve të ofruara;
  - 1.6 Kontribuon në vetëdijësimin dhe edukimin e përgjithshëm rreth sigurisë në aviacion dhe ndihmon personelin e autorizuar në hetimin e aksidenteve ajrore, dhe;
  - 1.7 Përgatit punime informuese dhe informon departamentet tjera të AAC-së në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me SHNA.
2. Numri i pozitive në Divizionin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror është katër (4): Udhëheqësi i Divizionit, një (1) Inspektor i komunikimit, navigacionit dhe survejimit, një (1) Inspektor për meteo dhe shërbime të informatave aeronautike, dhe një (1) inspektor për menaxhim të trafikut ajror.

#### **Neni 18**

### **Divizioni i Aerodromeve**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Aerodromeve janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për aerodromeve, heliporte dhe fusha ajrore, duke përfshirë këtu edhe planifikimin dhe realizimin e mbikëqyrjeve të rregullta dhe ad hoc të operatorëve të aerodromeve, heliporteve, fushave ajrore dhe shërbimeve përcjellëse (përfshirë infrastrukturën), ofruesit e shërbimeve në tokë, ofruesve të trajnimeve;
  - 1.2 Shqyrtimi i aplikacioneve dhe dhënia e rekomandimeve departamentit përkatës, për certifikim dhe aprovim të aerodromeve, ndërtim në zonat mbrojtëse, aprovim të ofruesve për shërbime në tokë si dhe aprovim të ndryshimeve operationale në aerodrome, heliporte dhe të ofruesve të shërbimeve;
  - 1.3 Propozimi për hartim të rregulloreve dhe udhëzuesve shoqëruar si dhe ofrimi i përkrahjes në proceset shoqëruar të konsultimit publik;

- 1.4 Hetimi i ndodhive lidhur me shkeljet e rregullave të sigurisë dhe rekomandimi i veprimeve korrigjuese për rritjen e sigurisë së shërbimeve të ofruara në aerodrome;
  - 1.5 Përgatit punime informuese dhe informon departamentet tjera të AAC-së për çështje me rëndësi;
  - 1.6 Verifikimi i informatave para publikimit në AIP, rishikimi i procedurave të operimit dhe hartave aeronautike dhe kontrollimi i manualeve, programeve, planeve, doracakëve dhe procedurave të operimeve dhe të mirëmbajtjes të aplikueshme në aerodrome dhe heliporte.
  - 1.7 Reagimi në emergjenca sipas Planit Emergjent të Aerodromit dhe procedurave të brendshme.
2. Numri i pozitave në Divizionin e Aerodromeve është katër (4): Udhëheqës i Divizionit, dhe tre (3) Inspektor të aerodromeve/heliporteve.

### **Neni 19**

#### **Divizioni i Rregullimit Ekonomik të Aviacionit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Rregullimit Ekonomik të Aviacionit janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për rregullim ekonomik të operatorëve të aerodromeve, OSHNA dhe ofruesit e shërbimeve në tokë;
  - 1.2 Planifikimi dhe realizimi i mbikëqyrjeve të rregullta dhe ad hoc të operatorëve të aeroporteve, ofruesve të shërbimeve të navigimit ajror dhe ofruesve të shërbimeve në tokë për zbatimin e legjislacionit përkatës dhe rregullave dhe standardeve të rregullimit ekonomik;
  - 1.3 Propozon hartimin e rregulloreve dhe udhëzuesve shoqërues si dhe ofron përkrahje në proceset shoqëruese të konsultimit publik në fushën e rregullimit ekonomik të aviacionit dhe i propozon amandamentimet e nevojshme të legjislacionit ekzistues;
  - 1.4 Shqyrtimi i aplikacioneve dhe dhënia e rekomandimeve departamentit përkatës, për aprovimin/miratimin e operatorëve ekonomik të aviacionit;
  - 1.5 Shqyrtimi i aplikacioneve për ndryshim ose modulim të tarifave në aeroporte në pajtueshmëri me parimet e Konventës së Cikagos dhe rregulloret e AACK-së mbi tarifatat në aeroporte dhe ofrimi i rekomandimeve përkatëse;
  - 1.6 Shqyrtimi i kërkesave për aprovim të tarifave vjetore për shërbimet e navigimit ajror në pajtueshmëri me parimet e Konventës së Cikagos, rregulloret e BE-së mbi “Qiellin e vetëm evropian” si dhe rregulloret e AACK-së mbi tarifatat e navigimit ajror dhe ofrimi i rekomandimeve përkatëse;
  - 1.7 Shqyrtimi i skemave nxitëse të propozuara nga aeroportet ose shërbyesit e navigimit ajror në pajtueshmëri me rregulloret në fuqi dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse;
  - 1.8 Auditimi i pasqyrave financiare të aeroportit, të shërbyesve të navigimit ajror dhe të ofruesve të shërbimeve në tokë në baza vjetore dhe ad hoc;
  - 1.9 Ndërmerr hetime për shkelje të rregullave dhe standardeve të zbatueshme për operatorët ekonomik dhe rekomandon veprimet korrigjuese.

Numri i pozitave në Divizionin e Rregullimit Ekonomik të Aviacionit është tre (3): Udhëheqësi i Divizionit dhe dy (2) Inspektor të rregullimit ekonomik.

## Neni 20

### Divizioni i Standardizimit, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integritimeve Evropiane

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Standardizimit, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integritimeve Evropiane janë:
  - 1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi si dhe ofrimi i këshillave juridiko-ligjore në lëmin e të drejtës së aviacionit civil dhe të çështjeve rregullatore ligjore në përgjithësi, brenda fushëveprimit të AAC-së;
  - 1.2 Bashkërendon procesin e përgatitjes së akteve juridike, shqyrton konsistencën e tyre me dispozitat e tjera ligjore në vend, siguron harmonizimin e tij me legjislacionit e BE-së si dhe Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, konform standardeve për hartimin e legjislacionit;
  - 1.3 Rishikimi finale i akteve nënligjore dhe instrumenteve tjera ligjore në kompetencë të AAC-së;
  - 1.4 Ofron ndihmë në hartimin e legjislacionit dhe siguron pajtueshmërinë me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovë si dhe me të drejtën ndërkombëtare të aviacionit, duke përfshirë këtu Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe legjislacionit e BE-së;
  - 1.5 Përgatitjen e mendimeve juridike për aktet nënligjore, aktet administrative dhe projekt aktet e tjera normative të përgatitura nga strukturat përgjegjëse;
  - 1.6 Ndhmon dhe koordinon me Ministrinë e Integritimeve Evropiane procesin e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionit e Bashkimit Evropian (Acquis të BE-së);
  - 1.7 Përgatitjen, ndjekjen, realizimin e politikave dhe veprimtarive rregullatore që lidhen me studimet në fushën e legjislacionit për aviacionin civil, kryerjen dhe përfundimin e analizave tekniko-ligjore të vlerësimit, të efektivitetit të legjislacionit, të procesit legjislativ, si dhe metodologjisë dhe teknikës së hartimit të legjislacionit, dhe
  - 1.8 Krijon dhe mirëmban ndërlidhje me organizatat ndërkombëtare dhe ato evropiane të aviacionit siç janë: ICAO, EASA, EUROCONTROL-i, ECAC, etj.
2. Udhëheqësi i Divizionit të Standardizimit, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integritimeve Evropiane për detyrat dhe përgjegjësitë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.

Numri i pozitave në Divizionin për Legjislacion dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar është katër (4). Udhëheqësi i divizionit, dy (2) zyrtar ligjor të aviacionit, një (1) zyrtar për marrëdhënie ndërkombëtare dhe integritimeve evropiane. Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjenden në Shtojcën një (1) të rregullores.

## Neni 21

### Divizioni për Shërbime të Menaxhimit të Përgjithshëm

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbime të Menaxhimit të Përgjithshëm janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi si dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave dhe ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të përgjithshëm;

- 1.2 Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të procedurave dhe ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të dokumenteve dhe lëndës arkivore;
  - 1.3 Ofrimi i shërbimeve të logjistikës dhe mirëmbajtjes së ndërtesave, objekteve dhe infrastrukturës në pajtim me procedurat përkatëse;
  - 1.4 Ofrimi i shërbimeve për fushën e Teknologjisë Informative (IT) në mirëmbajtje të rrjetit dhe pajisjeve që janë në shfrytëzim të personelit;
  - 1.5 Ofrimi i shërbimeve të transportit dhe mirëmbajtja e parkut të automjeteve;
  - 1.6 Shqyrtimi i kërkesave për hapësirë të zyrave;
2. Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhim të Shërbimeve të Përgjithshme për detyrat dhe përgjegjësitë raporton tek Drejtori i Përgjithshëm.

Numri i pozitave në Divizionin për Menaxhim të Shërbimeve të Përgjithshme është katër (4): Udhëheqësi i divizionit, një (1) zyrtar për TI, një (1) zyrtar i logjistikës dhe një (1) zyrtar për arkivë dhe protokol. Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

## **Neni 22**

### **Njësia e Burimeve Njerëzore**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Burimeve Njerëzore janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi në fushën e shërbimit civil si dhe bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë të personelit;
  - 1.2 Siguron zbatimin e legjislacionit ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
  - 1.3 Siguron mbarëvajtjen e procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, përgatitë konkurset, akt emërimet, procedon pagat dhe bën mirëmbajtjen e dosjeve të personelit;
  - 1.4 Këshillon dhe mbështet udhëheqësit e strukturave organizative të institucionit lidhur me përshkrimet adekuate të vendeve të punës, vlerësimin e punës së personelit në zhvillimin e karrierës dhe ngritjes profesionale;
  - 1.5 Mbështet punën e Komisionit për ankesa dhe parashtrësia dhe Komisionit disiplinor, dhe
  - 1.6 Përkrahë zhvillimin e vartësve përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.
2. Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore për detyrat dhe përgjegjësitë raporton tek Drejtori i Përgjithshëm.

Numri i pozitave në Njësinë e Burimeve Njerëzore është dy (2): Udhëheqësi i njësisë dhe një (1) zyrtar për trajnime. Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

## **Neni 23**

### **Njësia e Shërbimit të Menaxhimit Financiar**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Shërbimit të Menaxhimit Financiar janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi në fushën e menaxhimit të financave publike dhe është përgjegjës për të përgatitë propozimet buxhetore dhe koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat e institucionit;
- 1.2 Përgatitë raporte tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore mbi shpenzimet buxhetore në bazë të LMFP-së;
- 1.3 Konsolidon të dhënat në programin e BDMS në bazë të të dhënave nga linjat buxhetore;
- 1.4 Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njesisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- 1.5 Siguron që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga organizata buxhetore të dorëzohen për pagesë përmes sistemit të thesarit;
- 1.6 Mbikëqyrë të gjitha aspektet e raportimit buxhetor nga ana e organizatës buxhetore, dhe
- 1.7 Bën kontrollin e të hyrave mujore të AAC-së duke krahasuar me të dhënat e deklaruara nga operatori i aeroportit dhe ASHNA si dhe analizon të dhënat statistikore të ndërlidhura me bartjen e udhëtarëve, mallrave dhe postës përmes ajrit.

2. Udhëheqësi i Njesisë së Shërbimit të Menaxhimit Financiar për detyrat dhe përgjegjësitë raporton tek Drejtori i Përgjithshëm.

Numri i pozitave në Njesisë e Shërbimit të Menaxhimit Financiar është dy (2): Udhëheqësi i Njesisë dhe një (1) zyrtar i buxhetit dhe shpenzimeve. Përshkrimi i detyrave të punës për këto pozita gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

#### **Neni 24**

#### **Njësia e Prokurimit Publik**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Prokurimit Publik janë:

- 1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi në fushën e prokurimit publik dhe ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë;
- 1.2 Përgatit, koordinon dhe Zbatimi i planin vjetorë të prokurimit dhe siguron zbatimin e këtij plani në pajtim me legjislacionit dhe rregullat e prokurimit publik;
- 1.3 Ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
- 1.4 Planifikon, përpunon, mbikëqyr dhe Zbatimi i në mënyrë efektive e furnizimin me mallra dhe shërbime dhe bashkëpunon me institucionet përkatëse për prokurim publik, dhe
- 1.5 Siguron sistemimin e lëndëve sipas prioriteteve dhe urdhëresave të menaxhmentit dhe raporton rregullisht për punët e kryera dhe realizimin e detyrave.

2. Udhëheqësi i Njesisë së Prokurimit Publik për detyrat dhe përgjegjësitë raporton tek Drejtori i Përgjithshëm.



Numri i pozitave në Njësinë e Prokurimit Publik është një (1), menaxher i prokurimit. Përshkrimi i detyrave të punës për këtë pozitë gjendet në Shtojcën një (1) të rregullores.

### **KREU III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 25**

#### **Raporti i rregullores dhe akteve tjera të brendshme**

1. Të gjithë nëpunësit e AAC-së janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës e dt. 17 janar 2011, me ndryshime dhe plotesime.
3. Shfuqizohet çdo akt tjetër në formën e vendimit, urdhrit apo të udhëzimit, manualit apo procedurës që rregullon çështjet e brendshme të funksionimit dhe organizimit të punës në AAC dhe që bie ndesh me këtë rregullore.

#### **Neni 26**

#### **Dispozitat kalimtare**

1. Rekrutimi për pozitat e lira sipas kësaj rregulloreje do të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit.
2. Shërbimet e menaxhimit të përgjithshëm mund të rregullohen me akte tjera nënligjore sipas legjislacionit në fuqi për organizimin e administratës shtetërore.
3. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore të ndërmer veprimet administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi.
4. Organogrami i detajuar i AAC-së sipas kësaj rregulloreje është bashkëngjitur si Shtojca nr. 2.

#### **Neni 27**

#### **Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet nga Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me nevojat administrative dhe organizative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 28**

#### **Kategorizimi i pagave**

Kategorizimi i pagave për nëpunësit e AAC-së do të bëhet sipas kategorizimit të pozitave të përcaktuara me Ligjin nr. 06/l-111 për pagat në sektorin publik, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / nr. 7 / 01 mars 2019. Deri në implementimin e këtij ligji, pagat e nëpunësve civil në AAC do të ekzekutohen sipas shkresave Nr.277 të datë 07.04.2009 dhe Nr.364 të datë 04.06.2010 të Ministrisë për Administratën Publike.

**Neni 29**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe publikohet në faqen zyrtare dhe në Gazetën Zyrtare në afat prej 15 ditësh nga miratimi i saj.



**Eset Berisha**  
Drejtori i Përgjithshëm

# AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS

